



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:250870  
Datë: 30.09.2024  
Numri i dokumentit: 06229705

**Ac.nr.9620/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka e Burim Shala - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.B., nga fshati..., komuna e Skenderajit, të cilën me autorizim e përfaqëson av.A.F., nga Prishtina, kundër të paditurës N.P.T “B...”, me pronar G.Z. - me seli në fshatin..., komuna e Ferizajit, të cilën me autorizim e përfaqëson av. K.A., nga Ferizaj, për shkak të kompensimit të dëmit material, duke vendosur sipas ankesës së paditësit dhe të paditurës, të paraqitura kundër kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, C.nr.38/20, të datës 31.08.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **30.09.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHEN** të pathemelta ankesa e paditësit S.B., nga fshati..., komuna e Skenderajit, dhe ankesa e të paditurës N.P.T “B...”, me pronar G.Z. - me seli në fshatin..., komuna e Ferizajit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj, C.nr.38/20, të datës 31.08.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.38/20, të datës 31.08.2021, në pikën *I (një)* të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit S.B., nga fshati..., komuna e Skenderajit. Në pikën *II (dy)* të dispozitivit e ka detyruar të paditurën N.P.T “B...” me pronar G.Z., me seli në fshatin..., komuna e Ferizajit në emër të kompensimit të dëmit material, për shkak të investimeve për mbjelljen dhe rritjen e fidanëve të mjedrës ti paguaj paditësit S.B. nga fshati..., komuna e Skenderajit, shumën prej 26,758.00€, dhe në emër të fitimit të humbur për periudhën kohore tri vjeçare ti paguaj shumën prej 37,530.00€, e në shumën e përgjithshme prej 64,288.00€, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të padis 11.10.2016 e deri ne pagesën definitive në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë te këtij aktgjykimi. Në pikën *III (tre)* të dispozitivit e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë në emër të

fitimit të humbur në shumën prej 92,470.00€, si të pabazuar. Në pikën IV (*katër*) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën N.P.T “B...” me pronar G.Z. me seli në fshatin..., komuna e Ferizajit, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore paditësit S.B. të ia paguaj shumën prej 2,903.00€, në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pikën V (*pesë*) të dispozitivit, e ka obliguar paditësin S.B. në emër të taksës gjyqësore për padi të paguaj diferencën bazuar në vlerën e kontestit shumën prej 150.00€, pasi që janë paguar vetëm 20.00€ në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, paditësi ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, duke e aprovuar këtë ankesë të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e precizuar të paditësit.

Poashtu kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, e paditura ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, duke e aprovuar këtë ankesë të bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në pikën I, II, IV, dhe të refuzohet kërkesëpadija e paditësit, kurse pjesa e paankimuar pika III e dispozitivit të vërtetohet, dhe të detyrohet paditësi t'ia paguajë shpenzimet e procedurës të paditurit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- *Ankesa e paditësit është e pathemeltë.*
- *Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 11.10.2011, në Gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për shkak të kompensimit të dëmit, kundër të paditurës së lartcekur, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë dhe pas shqyrtimit të provave dhe të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.38/20, të datës 31.08.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi me marrëveshje-kontratë të datës 09.10.2014, ka blerë nga e paditura 20 mijë fidan të mjedrës në çmim prej 0.60 cent, për një fidan dhe llogaritur në shumën totale prej 12 mijë euro, po ashtu kontestuese nuk ishte fakti se paditësi me dt.07.12.2015 të paditurës ia ka kryer pagesën prej 12 mijë euro, për fidanët e blera, gjithashtu nuk ishte kontestuese fakti se paditësi ka kryer edhe mbjelljen e fidanëve. Çështje kontestuese mes palëve ishte cilësia e fidanëve të cilat ia ka dorëzuar e paditura paditësit

i cili pretendon se nuk i ka pranuar fidanët të cilët kanë qenë të përcaktuar me marrëveshje, ku të njëjtat sipas tij kanë qenë të infektuara e si pasojë e kësaj i është shkaktuar edhe dëmi, e paditura pretendon se fidanët e kanë pasur cilësinë e duhur. Tutje gjykata për të vërtetuar shkaktarin dhe lartësinë e dëmit ka caktuar ekspert A.C.- agronom, i cili në ekspertizën e tij ka dhënë mendimin se fidanët e importuara të mjedrës janë të infektuara nga dy patogjene, nga tharja e fidanit dhe nga kanceri i rrënjës, dëmin e shkaktuar ndaj paditësit e ka llogaritur në shumën prej 26,758.00, ndërsa fitimin e humbur e ka llogaritur në vlerë prej 96,758.00€. Pala e paditur nuk u pajtua me këtë ekspertizë andaj propozoi kryerjen e ekspertizës tjetër. Eksperti tjetër gjyqësor prof. H.M., në mendimin e tij theksoi se prona është vend shumë i përshtatshëm për kultivimin e mjedrës duke e llogaritur sipërfaqen e dëmtuar prej 2 hektarë, fitimi i pastër për një vit për pronarin e tokës do të ishte 13 mijë euro, ndërsa në emër të dëmit material për shkak të investimeve totali i shpenzimeve ka qenë në shumën prej 26,758.00€. Pala e paditur nuk u pajtua as me këtë mendim profesional andaj propozoi ekspertizë nga grupi i ekspertëve, gjykata caktoi grupin e ekspertëve në përbërje prej S.B., J.K. dhe A.Q., të gjithë vlerësues të shkallës IA dhe në sqarimet shtesë në seancën kryesore kanë dhënë mendimin profesional se vlera e përgjithshme e dëmit për rendimentin vjetor për sipërfaqen 19.857 m<sup>2</sup>, me të gjitha investimet e bëra, arrijnë vlerën prej 39,268.00€, ndërsa rendimenti vjetor me neto të ardhura arrin vlerën prej 12,510.00€, dhe është llogaritur për periudhën kohore viti i parë dhe është llogaritur për periudhën tri vjeçare duke u pjesëtuar për tri vite rendimente dhe varësisht nga vendimi i gjykatës për sa vite do të vendos për kompensimin e dëmit. Gjykata mendimin e grupit të ekspertëve ia fali besimin dhe e vlerësoi si profesional dhe shkencor. Gjykata konstatoi se nga marrëveshja për shitblerjen e fidanëve palët kanë hyrë në raport detyrimor, andaj nuk e morri për bazë pretendimin e të paditurit se i njëjti nuk është përgjegjës për shkaktimin e dëmit. Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata i është referuar nenit 173 të LMD.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar palët me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK dhe se kërkesa e paditësit është parashkruar. Në bazë të nenin 257 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i cili shprehimisht përcakton *“Kërkesë shpërblimi të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin. Siç shihet nga shkresat e lëndës paditësi padinë e ka paraqitur me datë 11.10.2016, ndërsa për dëmin ka mësuar me datë 16.06.2015, ku nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari është informuar se fidanët e mbjellura kanë dështuar 50% dhe kanë rezultuar të infektuara. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.*

Gjykata i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së ekspertëve S.B., J.K. dhe A.Q., i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Nuk qëndrojnë pretendimet e ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjendjen faktike për dëmin material gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes ekspertizave të ekspertëve vlerësues të agronomisë së shkallës IA, të cilët kanë dhënë shpjegimet e tyre në arsyetim të aktgjykimit, prandaj në këtë kontekst edhe Gjykata e Apelit i ka pranuar në tërësi vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pabazuara pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale. Kjo ngase me nenin 136 par.1 të LMD së zbatuar për këtë rast (Nr.04/L-077), parashihet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Me nenin 173 par.1 parashihet se *“ I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur”*. Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materiale - juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesën e aprovuar në shumën sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata është e mendimit se e njëjta është adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit si dhe fitimin e humbur, me këtë do t'i mundësohet të dëmtuarit - këtu paditësit, satisfaksion që ai me këto mjete t'i riparoj në një masë nevojat e tij materiale. Mbi këtë bazë gjykata e shkallës së dytë vlerëson se pretendimet e palëve ankuese për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, në rastin konkret janë të pabazuara, për çka edhe është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e palës paditëse, lidhur me pikën III të aktgjykimit të ankimuar, sa i përket pjesës së refuzimit të pjesërishtë të kërkesëpadisë, gjykata u bazua në mendimin e ekspertëve të cilët e kanë llogaritur fitimin e humbur për tri vite. Gjykata ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme pasi, që kërkesëpadia sa i përket pjesës së fitimit të humbur për 10 vite nuk qëndron e bazuar në faktin se siç edhe përshkruhet në ekspertizë: *“te shumica e llojeve të pemëve kohëzgjatja e implementimit të projektit zgjat tri vite”*, andaj edhe Gjykata e Apelit vlerësoi se nuk mund të kërkohej kompensim për periudhë më të gjatë kohore.

Përfundimisht, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të

procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 par.1 të LPK.

Edhe për kumatën gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur drejtë dhe në pajtim me dispozitat e nenit 382 të LMD-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e të lartcekurave, Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par.1, pika (d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.9620/21, datë 30.09.2024**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**